



REPUBLIKA E SHQIPËRIE



Nr. 523/ Prot.

Shkodër me 23.09 2024

V E N D I M

Nr. 22, datë 20.09.2024

Për miratimin e draft marrëveshjes dhe fillimin e procedurave për zbatimin e projektit SMARTMOBAIR në kuadër të Programit Interreg ADRION.

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 20.09.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi relacionin përkatës të përgatitur nga administrata Për miratimin e draft marrëveshjes dhe fillimin e procedurave për zbatimin e projektit SMARTMOBAIR në kuadër të Programit Interreg Ipa-ADRION, të propozuar nga **Partneri Udhëheqës i Projektit, Area Science Park-Trieste, Itali**, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", dhe Ligjit Nr. Ligj Nr. 68/2017, neni 30 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhëzimi Nr. 35, datë 21.09.2020 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", në vijim të bashkëpunimit në projektin nr. 134, SMARTMOBAIR të miratuar në shkurt të këtij viti, nga Autoriteti Menaxhues i Programit Interreg Ipa-Adrion Programe dhe në kuadër të përfshirjes së Këshillit të Qarkut Shkodër si partner,

VENDOSI:

1. Miratimin e draft marrëveshjes së projektit SMARTMOBAIR, i cili ka për qëllim zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve inteligjente për mobilitetin në zonën e programit Interreg Ipa-Adrion, në kuadër të përmirësimit të sistemit të mobilitetit të qëndrueshëm dhe përfshirës.
2. Fillimin e procedurave për zbatimin e projektit në Këshillin e Qarkut Shkodër, sipas hapave të parashikuar në marrëveshje dhe në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore financiare dhe organizative.
3. Ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër për nënshkrimin e marrëveshjes me Partnerin Udhëheqës dhe për mbikëqyrjen e procedurave të mëtejshme për zbatimin e projektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

